



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 212/2013

28 janar 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i ERRU nr. 40, datë 11.12.2013	Për rinovim licence sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Sarandë.....	9259
Vendim i ERRU nr. 41, datë 11.12.2013	Për rinovim licence “Elber” sh.p.k.....	9259
Vendim i ERRU nr. 42, datë 23.12.2013	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Korçë.....	9260
Vendim i ERRU nr. 43, datë 23.12.2013	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Ersekë.....	9260
Vendim i ERRU nr. 44, datë 27.12.2013	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Gjirokastrë (qytet).....	9261
Vendim i ERRU nr. 45, datë 27.12.2013	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Lezhë.....	9262
Vendim i ERRU nr. 46, datë 27.12.2013	Për miratimin e “Bilancit të ujit”.....	9262
Vendim i ERRU nr. 47, datë 30.12.2013	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Tepelenë.....	9270
Vendim i ERRU nr. 48, datë 30.12.2013	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për bashkinë Pukë.....	9270
Vendim i ERRU nr. 49, datë 30.12.2013	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Sarandë.....	9271
Vendim i ERRU nr. 50, datë 30.12.2013	Për miratimin e formatit të licencës dhe disa ndryshime në rregulloren e licencimit.....	9271

Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasit Thoma Prifti.....	9278
Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasit Sefer Rabeta.....	9278
Ndreqje gabimi.....	9279

VENDIM
Nr. 40, datë 11.12.2013

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME SARANDË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, operatorit sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Sarandë, me:

Drejtues ligjor: Durim Bajo

Drejtues teknik: Durim Bajo.

2. Operatori UK Sarandë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është bashkia Sarandë, komunat: Aliko, Dhiver, Finiq (pjes.), Mesopotam (pjes.).

4. Kjo licencë është e vlefshme deri në datën 13.6.2016, siç është përcaktuar në vendimin e KKRR-së nr. 14, datë 13.6.2012.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr. 41, datë 11.12.2013

PËR RINOVIM LICENCE “ELBER” SHPK

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, operatorit “Elber” sh.p.k., me:

Drejtues ligjor: Altin Cenolli

Drejtues teknik: Astrit Mënalla.

2. Operatori “Elber” sh.p.k. autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është bashkia Elbasan.

4. Kjo licencë është e vlefshme deri në datën 19.1.2015, siç është përcaktuar në vendimin e KKRR-së nr. 6, datë 19.1.2011.

KRYETARI
Avni Dervishi



VENDIM
Nr. 42, datë 23.12.2013

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA UK KORÇË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, si dhe vendimit të KKRR-së nr. 35, datë 14.10.2013 “Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2014”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të sh.a. UK Korçë:

a) Tarifë volumetrike për shërbimet:

	Furnizimi me ujë	Largimi e përpunimi i ujërave të ndotura
Konsumator familjar	65 lekë/m ³	34 lekë/m ³
Institucione buxhetore	110 lekë/m ³	56 lekë/m ³
Ente private	140 lekë/m ³	56 lekë/m ³

b) Tarifë fikse: 120 lekë/muaj/klient.

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2014:

- uji pa të ardhura (humbjet) 24 %
- niveli i matjes 100 %
- kohëzgjatja e furnizimit 24 orë/ditë
- eficientia e energjisë 0.78 kwh/m³
- efikasiteti i stafit 2.29 p/000/lidhje
- mbulimi me ujë 100 %
- mbulimi me kanalizime 94 %
- norma e arkëtimit 91 %
- cilësia e ujit (klor + koliform) sipas standardeve.

2. Pagesa rregullatore për sh.a. UK Korçë do të jetë 0.8% e të ardhurave të llogaritura.

3. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2014 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

4. Vendimi nr. 43, datë 23.12.2011, shfuqizohet.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr. 43, datë 23.12.2013

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA UK ERSEKË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, si dhe vendimit të KKRR-së nr. 35, datë 14.10.2013 “Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2014”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të sh.a. UK Ersekë:

a) Tarifë volumetrike për shërbimet:

	Furnizimi me ujë	Largimi i ujërave të ndotura
Konsumator familjar	35 lekë/m ³	8 lekë/m ³
Institucione buxhetore	90 lekë/m ³	12 lekë/m ³
Ente private	110 lekë/m ³	18 lekë/m ³

b) Tarifë fikse: 100 lekë/muaj/klient.

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2014:

- uji pa të ardhura (humbjet) 62 %

- niveli i matjes 75 %
- kohëzgjatja e furnizimit 6 orë/ditë
- efienca e energjisë 2.6 kwh/m³
- efikasiteti i stafit 5.5 p/000/lidhje
- mbulimi me ujë 100 %
- mbulimi me kanalizime 100 %
- norma e arkëtimit 92 %
- cilësia e ujit (klor + koliform) sipas standardeve.

3. PAGESA RREGULLATORE PËR SH.A. UK ERSEKË DO TË JETË 0.8% E TË ARDHURAVE TË LLOGARITURA.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2014 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

5. Vendimi nr. 7, datë 30.3.2009, shfuqizohet.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr. 44, datë 27.12.2013

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA UK
GJIROKASTËR (QYTET)

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, si dhe vendimit të KKRR-së nr. 35, datë 14.10.2013 “Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2014”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të sh.a. UK Gjirrokastër qytet:

a) Tarifë volumetrike për shërbimet:

	Furnizimi me ujë	Largimi i ujërave të ndotura
Konsumator familjar	39 lekë/m ³	9 lekë/m ³
Institucione buxhetore	112 lekë/m ³	14 lekë/m ³
Ente private	124 lekë/m ³	14 lekë/m ³

b) Tarifë fikse: 80 lekë/muaj/klient.

c) Tarifë shitje uji me shumicë: 2.2 lekë/m³.

(Komuna Antigone)

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2014:

- uji pa të ardhura (humbjet) 65 %
- niveli i matjes 15 %
- kohëzgjatja e furnizimit 5 orë/ditë
- efienca e energjisë 0.8 kwh/m³
- efikasiteti i stafit 6 p/000/lidhje
- mbulimi me ujë 92 %
- mbulimi me kanalizime 50 %
- norma e arkëtimit 91 %
- cilësia e ujit (klor + koliform) sipas standardeve.

3. PAGESA RREGULLATORE VJETORE PËR SH.A. UK GJIROKASTËR QYTET DO TË JETË 0.8% E TË ARDHURAVE TË LLOGARITURA.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2014 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

5. Vendimi i KKRR-së nr. 37, datë 21.12.2012 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik”, shfuqizohet.

KRYETARI
Avni Dervishi



VENDIM
Nr. 45, datë 27.12.2013

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA UK LEZHË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, si dhe vendimit të KKRR-së nr. 35, datë 14.10.2013 “Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2014”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të sh.a. UK Lezhë:

a) Tarifë volumetrike për shërbimet:

	Furnizimi me ujë	Largimi i ujërave të ndotura
Konsumator familjar	58 lekë/m ³	18 lekë/m ³
Institucione buxhetore	135 lekë/m ³	22 lekë/m ³
Ente private	145 lekë/m ³	27 lekë/m ³

b) Tarifë fikse: 200 lekë/muaj/klient.

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2014:

- uji pa të ardhura (humbjet) 47 %
- niveli i matjes 75 %
- kohëzgjatja e furnizimit 20 orë/ditë
- eficientia e energjisë 2.5 kwh/m³
- efikasiteti i stafit 6 p/000/lidhje
- mbulimi me ujë 90 %
- mbulimi me kanalizime 90 %
- norma e arkëtimit 85 %
- cilësia e ujit (klor + koliform) sipas standardeve.

3. Pagesa rregullatore vjetore për sh.a. UK Lezhë do të jetë 0.8% e të ardhurave të llogaritura.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2014 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

5. Vendimi i KKRR-së nr. 1, datë 7.1.2013 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik”, shfuqizohet.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr. 46, datë 27.12.2013

PËR MIRATIMIN E “BILANCIT TË UJIT”

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/e, pika 1/i të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:


1. Të miratojë “Bilancin e ujit” sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Avni Dervishi



BILANCI I UJIT



Tiranë, dhjetor, 2013

A. Të përgjithshme

“Bilanci i ujit” është një informacion në lidhje me:

- Sasinë e ujit të prodhuar dhe të furnizuar në sistemin e furnizimit me ujë të zonës së shërbimit të operatorit;
- Sasinë e ujit të humbur për shkak të problemeve teknike të sistemit (rrjedhje të tubacioneve apo humbjeve në pjesë të ndryshme të sistemit) apo matësve të ujit;
- Sasinë e ujit të humbur për shkak të lidhjeve ilegale apo problemeve të keqadministrimit të sistemit;
- Sasinë e ujit të furnizuar te klientët;
- Sasinë e ujit të përdorur për qëllime publike (sistemet kundër zjarrit, pastrimi i rezervuarëve, rrugëve apo ujitja e lulishteve etj.) dhe për institucione të veçanta (kisha, xhami, jetimore, azile etj.).

“Bilanci i ujit”, në radhë të parë, u shërben operatorëve për të vërejtur dhe për të kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme problematikën që ndodh gjatë administrimit të sistemit të furnizimit me ujë në pjesë të ndryshme të tij, në mënyrë që të gjejë zgjidhjet përkatëse në një kohë sa më të shkurtër. “Bilanci i ujit” duhet të bëhet çdo muaj nga operatorët e ujit në bazë të të dhënave të matura apo të vlerësuara nga specialistët përkatës që operojnë në terren.

Operatorët e ujit duhet të synojnë drejt matjeve të vazhdueshme të sasive të ujit që kërkohen gjatë plotësimit të këtij Bilanci nëpërmjet instalimit të matësve të ujit në vendet e prodhimit të tij (burime, stacion pompash, puse etj.). Në rast të mungesës së matësve të ujit, operatorët duhet të bëjnë matje direkte dhe llogaritjet përkatëse çdo muaj (matjet dhe llogaritjet duhet të shoqërohen me procesverbale të rregullta zyrtare), në mënyrë që rezultatet të jenë sa më të sakta.

Njëkohësisht, “Bilanci i ujit”, i plotësuar nga operatorët, do të jetë një instrument që do t’u shërbejë ERRU-së dhe pronarëve të këtyre sistemeve (pushteteve lokale) për të monitoruar performancën dhe cilësinë e shërbimit të operatorëve të ujit. Ky Bilanci, i plotësuar me të dhënat e kërkuara të sasive të ujit sipas tabelave bashkëlidhur, duhet të dërgohet tek ERRU-ja dhe te pronarët një herë në 6 muaj. ERRU-ja do të bëjë kontrolle dhe monitorime për cilësinë e të dhënave të paraqitura.

B. Terminologjia standarde dhe përkufizimet e përbërësve të “Bilancit të ujit”

1. “Volumi i ujit që hyn në sistemin e furnizimit me ujë” është sasia e ujit të prodhuar në një vit kalendarik nga sistemi që administron operatori plus sasinë e ujit të blerë me shumicë nga klientë të tjerë në një vit.



2. “Konsumi i autorizuar” është volumi i ujit të matur dhe të pamatur, që merret nga konsumatorët e regjistruar, si dhe furnizues të tjerë për qëllime komerciale, industriale me autorizimin e operatorit të ujit. Këtu përfshihet edhe uji që u jepet të tretëve, si dhe uji për sistemet kundër zjarrit dhe për qëllime të infrastrukturës publike.

3. “Humbjet e ujit” është volumi total i ujit që humbet në të gjithë sistemin e furnizimit me ujë. Humbjet përfshijnë humbjet e dukshme dhe humbjet reale.

4. “Humbjet reale” janë humbjet fizike të ujit në sistemin e furnizimit me ujë deri në pikën e matjes te konsumatori. Në këto humbje përfshihen të gjitha tipat e rrjedhjeve në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, nga mbirrjedhjet e depove, rrjedhjet për shkak të riparimeve në sistem, rrjedhjet në stacionin e pompave dhe në burimet e ujit.

5. “Humbjet e dukshme” konsistojnë në konsumin e paautorizuar (vjedhje dhe lidhje ilegale), si dhe të gjitha llojet e pasaktësive në matjen e ujit në prodhim dhe te konsumatori.

6. “Konsumi i ujit të faturuar i matur” është sasia vjetore e ujit të matur nëpërmjet matësve të ujit të instaluar te konsumatorët dhe të faturuar nga operatori.

7. “Konsumi i ujit të faturuar i matur që u shitet të tretëve” është sasia vjetore e ujit të matur nëpërmjet matësve të mëdhenj të ujit, i cili u shitet operatorëve të tjerë ose klientëve të caktuar jashtë zonës së shërbimit me tarifën e ujit me shumicë, të aprovuar nga ERRU-ja.

8. “Konsumi i ujit të faturuar i pamatur” është sasia vjetore e ujit të vlerësuar nga operatori që u është shitur dhe faturuar klientëve familjarë dhe jofamiljarë (privatë apo institucione). Në këtë sasi përfshihet konsumi i ashtuquajtur aforfe, që u faturohet klientëve sipas VKM-së përkatëse (konsum i vlerësuar me sasinë prej 150 l/frymë në ditë për konsumatorët familjarë pa matës) ose përdorues të tjerë që nuk kanë të instaluar matës uji.

9. “Konsumi i ujit të pafaturuar që jepet nga operatori për qëllime dhe institucione të veçanta” është sasia vjetore e ujit që jepet nga operatori për qëllime publike të veçanta (ujitja e lulishteve, shuarja e zjarreve përmes sistemeve zjarrfikëse, pastrimin e depove të ujit dhe rrugëve etj.). Kjo sasi mund të jetë e matur ose e vlerësuar nga operatori në bazë të normave dhe rregullave përkatëse.

10. “Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjat e transmetimit” është sasia e ujit që merret ilegalisht në linjat e transmetimit nga burimi i ujit (stacion pompash apo burim sipërfaqësor) deri te rezervuarët e ujit, si rrjedhojë e lidhjeve ilegale apo *bypass*-eve tek ujëmatësi i konsumatorit, të kryera nga persona të paautorizuar nga operatori.

11. “Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjat e rrjetit shpërndarës” është sasia e ujit që merret ilegalisht në linjat e rrjetit shpërndarës nga rezervuarët e ujit deri te pika e lidhjes për konsumatorin, si rrjedhojë e lidhjeve ilegale apo kalimeve tek ujëmatësi i konsumatorit, të kryera nga persona të paautorizuar nga operatori.

12. “Humbjet e ujit për shkak të pasaktësive në matësit e ujit (në prodhim dhe te konsumatori)” është sasia e ujit që humbet nga pasaktësia e ujëmatësve të instaluar në vendet e prodhimit dhe të konsumimit të ujit.

13. “Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit” është sasia vjetore e ujit që humbet për shkak të rrjedhjeve në linjat e transmetimit nga burimi i ujit (stacion pompash apo burim sipërfaqësor) deri te rezervuarët e ujit, si rrjedhojë e defekteve apo amortizimit të tubacioneve të këtyre linjave.

14. “Humbjet e ujit nga rrjedhjet në burim dhe/ose stacionet e pompave” është sasia vjetore e ujit që humbet për shkak të rrjedhjeve të valvolave të komandimit, pjesëve të veçanta të sistemit të pompave (gominave, defekteve etj.) ose derdhjeve në zonën e grumbullimit të ujit të burimit (pusetave grumbulluese, kaptazheve etj.).

15. “Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rezervuarët e ujit” është sasia vjetore e ujit që humbet për shkak të rrjedhjeve në rezervuarët e ujit, si rrjedhojë e defekteve të tepërplotësve, rrjedhjeve të vogla në muret e rezervuarëve (nëse ka), mosoperimit në kohën e duhur të valvolave të kontrollit të rezervuarëve etj.

16. “Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e rrjetit shpërndarës” është sasia vjetore e ujit që humbet për shkak të rrjedhjeve në linjat e rrjetit shpërndarës nga rezervuarët e ujit deri te pika e lidhjes për konsumatorin, si rrjedhojë e defekteve apo amortizimit të tubacioneve të këtyre linjave.

17. “Humbjet e ujit nga rrjedhjet gjatë riparimeve në linjat e sistemit të furnizimit me ujë” është sasia e ujit që humbet për shkak të rrjedhjeve gjatë riparimeve që kryhen në linjat e tubacioneve të sistemit të furnizimit me ujë. Kjo sasi varet nga reagimi në kohë i operatorit, presioni i ujit, si dhe diametri i tubacionit ku kryhet ky riparim.

18. “Numri i lidhjeve të konsumatorëve aktivë të regjistruar (familjarë dhe jofamiljarë)” është numri i lidhjeve të konsumatorëve që përdorin sistemin e furnizimit me ujë në mënyrë të vazhdueshme dhe që kanë një kontratë shërbimi të regjistruar me operatorin.

19. “Numri i lidhjeve të konsumatorëve joaktivë të regjistruar (familjarë dhe jofamiljarë)” është numri i lidhjeve të konsumatorëve që nuk e përdorin sistemin e furnizimit me ujë në mënyrë të vazhdueshme për shkak të lëvizjeve të tyre jashtë zonës së shërbimit dhe që kanë një kontratë shërbimi të regjistruar me operatorin. Këta konsumatorë duhet të njoftojnë operatorin për ndërprerje të furnizimit me ujë gjatë kohës që nuk ndodhen në zonën e shërbimit dhe, në këtë rast, operatori do të faturojë vetëm tarifën fikse të shërbimit të aprovuar nga ERRU-ja.

20. “Numri i matësve të ujit të instaluar te konsumatori” është numri i matësve të ujit të instaluar në pikën e lidhjes te konsumatorët që përdorin sistemin e furnizimit.

C. Plotësimi i të dhënave dhe përdorimi i përbërësve të bilancit të ujit (manuali i përdorimit)

Modeli i llogaritjes së bilancit të ujit

Tabela 1

Vëllimi i ujit i prodhuar në sistem (=ujë i prodhuar) (1)	Konsumi i autorizuar	Konsumi i autorizuar i faturuar	Konsumi i matur i faturuar (duke përfshirë ujin e eksportuar)	Ujë me të ardhura	2, 3
			Konsum i faturuar i pamatur		4
		Konsumi i autorizuar i pafaturuar	Konsum i matur i pafaturuar		5
			Konsum i pamatur i pafaturuar		
	Humbjet e ujit	Humbjet e dukshme	Konsum i pa autorizuar	Ujë pa të ardhura (NRW)	6
			Pasaktësi në matjen e ujit		7
					8
		Humbjet reale	Rrjedhje në rrjetin e transmetimit dhe / ose të shpërndarjes		9,10,11,12,13
			Rrjedhje dhe derdhje në depot e magazinimit të ndërmarrjes		
			Rrjedhje nga linjat e shërbimit deri në pikën e matjes së konsumatorëve		

Shënim. Numrat 2-13, shikojë te tabela 2

Hapat për llogaritjen e ujit pa të ardhura dhe të humbjeve të ujit (llogaritja e bilancit të ujit):

Hapi I: Përcakto vëllimin e ujit të prodhuar që futet në sistem (tabela 1, kolona 1 ose tabela 2, rreshti 1)

Hapi II: Përcakto konsumin e matur të faturuar dhe konsumin e pamatur të faturuar (tabela 1, kolona 3, rreshti 1 ose tabela 2, rreshtat (2, 3, 4)), shumënd vendose te konsumi i autorizuar i matur dhe tek uji me të ardhura.

Hapi III: Llogarit vëllimin e ujit pa të ardhura si diferencën e vëllimit të ujit të prodhuar që futet në sistem minus konsumin e autorizuar të faturuar (tabela 1, kolona 3, rreshtat 2, 3, 4 ose tabela 2, rreshtat (5 – 13)).

Hapi IV: Përcakto konsumin e matur të pafaturuar dhe konsumin e pamatur të pafaturuar (tabela 1, kolona 3, rreshti 2 ose tabela 2, rreshti 5).

Hapi V: Shtoj vëllimet e konsumit të autorizuar të matur dhe të konsumit të autorizuar të pamatur, domethënë shumënd (tabela 1, kolona 3, rreshti 1 ose tabela 2, rreshtat (2, 3, 4, 5)).

Hapi VI: Llogarit humbjet e ujit (tabela 1, kolona 2, rreshti 2 ose tabela 2, rreshtat (6 – 13)), si diferencën midis vëllimit të ujit të prodhuar që futet në sistem dhe konsumit të autorizuar (tabela 1).

Hapi VII: Vlerëso komponentët e konsumit të paautorizuar dhe pasaktësi në matjen e ujit (tabela 1, kolona 4, rreshtat (5, 6) ose tabela 2, rreshtat (6, 7, 8)) në mënyrën më të mirë të mundshme dhe shtoj shumënd e tyre te humbjet e dukshme (tabela 1, kolona 3, rreshti 3).



Hapi VIII: Llogarit humbjet reale (tabela 1, kolona 3, rreshti 4 ose tabela 2, rreshti (9 – 13)), si diferencën e humbjeve të ujit minus humbjet e dukshme (tabela 1).

Hapi IX: Vlerëso komponentët e humbjeve reale (tabela 1, kolona 4, rreshtat (7, 8, 9) ose tabela 2, rreshtat (9 - 13)) në mënyrën më të mirë të mundshme, shtoji këto dhe verifikoji me vëllimin e humbjeve reale tek (tabela 1, kolona 3, rreshti 4), i cili u përcaktua në hapin VIII.

1. Volumi i ujit që hyn në sistemin e furnizimit me ujë duhet të matet nga operatori me anë të ujëmatësve që instalohen në vendet e marrjes së ujit (pusetat e kaptazheve në burim, tubat e daljes në stacionet e pompave etj.). Këto matje duhet të regjistrohen çdo ditë me anë të një procesverbali zyrtar dhe duhet të dorëzohen në zyrat qendrore të operatorit. Gjithashtu, në zyrat qendrore duhet të dorëzohet çdo ditë edhe procesverbali i sasisë së ujit të blerë me shumicë nga klienti.

Në rastet kur nuk ka të instaluar matës uji në vendet e marrjes së ujit, duhet të bëhen vlerësime të sasisë së ujit të prodhuar në bazë të vrojtimeve ditore dhe eksperiencës së specialistëve përkatës. Sasia e ujit të vlerësuar duhet të regjistrohet çdo ditë dhe të dorëzohet në zyrat qendrore të operatorit. Një herë në muaj, specialistët duhet të bëjnë matjet dhe llogaritjet përkatëse në bazë të sipërfaqes tërthore të tubit të daljes dhe shpejtësisë së matur të ujit në këtë segment. Këto matje duhet të kontrollohen me sasinë e ujit të vlerësuar çdo ditë nga specialistët.

2. Konsumi i ujit të faturuar i matur duhet të matet me anë të ujëmatësve që instalohen te konsumatori. Këto matje duhet të regjistrohen çdo muaj me anë të një procesverbali zyrtar dhe duhet të dorëzohen në zyrat qendrore të operatorit, dega e shitjes.

3. Konsumi i ujit të faturuar i matur që u shitet të tretëve, duhet të matet me anë të ujëmatësve që instalohen në pikën e lidhjes ku jepet uji që u shitet klientëve të caktuar ose klientëve të caktuar jashtë zonës së shërbimit me tarifën e ujit me shumicë të aprovuar nga ERRU-ja. Këto matje duhet të regjistrohen çdo ditë me anë të një procesverbali zyrtar dhe duhet të dorëzohen në zyrat qendrore të operatorit, dega e shitjes. Dega e shitjes duhet të bëjë regjistrimin e tyre.

4. Konsumi i ujit të faturuar i pamatur duhet të vlerësohet nga specialistët e operatorit në bazë të anëtarëve të regjistruar të familjes së konsumatorit (anëtarët e regjistruar të familjes duhet të vërtetohen përmes regjistrimit të gjendjes civile).

Konsumi i ujit, i vlerësuar në këtë rast, do të jetë i barabartë me sasinë e ujit prej 150 l/frymë në ditë (ose 4.5 m³/frymë në muaj) për konsumatorët familjarë. Përdoruesve të tjerë jofamiljarë, që nuk kanë të instaluar matës uji në muajin e parë, do t'u bëhet një vlerësim në bazë të normave të konsumit për llojin e aktivitetit që kryejnë. Në muajt e tjerë, këtyre klientëve duhet t'u instalohet matës uji në bazë të kërkesave të Kodit të Ujit.

Këto vlerësime duhet të regjistrohen çdo muaj me anë të një procesverbali zyrtar dhe duhet të dorëzohen në zyrat qendrore të operatorit, dega e shitjes. Dega e shitjes duhet të bëjë regjistrimin mujor të tyre.

5. Konsumi i ujit të pafaturuar që jepet nga operatori për qëllime dhe institucione të veçanta duhet të matet me anë të ujëmatësve që instalohen në pikat e lidhjeve të tyre. Këto matje duhet të regjistrohen çdo muaj me anë të një procesverbali zyrtar dhe duhet të dorëzohen në zyrat qendrore të operatorit, dega e shitjes. Dega e shitjes duhet të bëjë regjistrimin mujor të tyre.

Nëse kjo sasi nuk mund të matet (p.sh. sasia e ujit të përdorur nga hidrantët), operatori duhet të bëjë vlerësimin e tyre në bazë të normave dhe rregullave përkatëse (p.sh. sasia e ujit që përdoret nga një hidrant llogaritet të jetë 5 l/sek dhe koha e shuarjes së zjarrit llogaritet të jetë 3 orë).

6. Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjat e transmetimit janë humbje të dukshme që duhet të llogariten në bazë të diferencës së prurjeve të ujit në fillim dhe në mbarim të linjave të transmetimit, si dhe të investigimeve që duhet të bëjnë në terren specialistët e operatorit. Investigimi në terren duhet të bëhet të paktën një herë në muaj për të identifikuar lidhjet e paligjshme dhe kalimet e paautorizuara. Në bazë të diametrit të tubacionit, që është i lidhur te linja e transmetimit, mund të përcaktohen edhe sasia e ujit që humbet për shkak të këtyre lidhjeve. Nga eksperiencia rezulton se:

- Për tubacione që punojnë me presion < 16 bar dhe diametër d < 100 mm, këto humbje shkojnë deri në 20 m³/orë;

- Për tubacione që punojnë me presion < 16 bar dhe diametër $100 < d < 200$ mm, këto humbje shkojnë deri në $50 \text{ m}^3/\text{orë}$.

7. Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjat e rrjetit shpërndarës janë humbje të dukshme, që duhet të llogariten në bazë të investigimeve që duhet të bëjnë në terren specialistët e operatorit. Investigimi në terren duhet të bëhet të paktën një herë në muaj në nënzona të përcaktuara mirë të rrjetit shpërndarës për të identifikuar lidhjet e paligjshme dhe kalimet e paautorizuara që dërgojnë ujë te konsumatorët e nënzonës. Në bazë të diametrit të tubacionit, që është i lidhur te linja e transmetimit, mund të përcaktohen edhe sasia e ujit që humbet për shkak të këtyre lidhjeve.

Duhet theksuar se këto humbje, nga vetë vështirësia dhe kompleksiteti i problematikës që kanë, duhet të vërehen dhe të analizohen me kujdes nga operatori (këto humbje nuk duhet të ngatërrohen me humbjet për shkak të rrjedhjeve) dhe më pas të regjistrohen në zyrën qendrore të operatorit, dega e shitjes. Analiza e këtyre humbjeve duhet të shikohet ngushtë edhe me problematikat e tjera që mund të ketë në nënzona, siç mund të jetë përdorimi i ujit për qëllime ujëtie, niveli social dhe ekonomik i konsumatorëve të kësaj nënzona etj.

8. Humbjet e ujit për shkak të pasaktësive në matësit e ujit (në prodhim dhe te konsumatori janë humbje të dukshme që duhet të llogariten në bazë të shkallës së gabimit të dhënë nga vetë prodhuesi, si dhe duke marrë për bazë vjetërsinë dhe gjendjen aktuale të matësve të ujit të instaluar në sistem. Gjithashtu, specialistët e operatorit duhet të bëjnë investigime për gjendjen aktuale të paktën një herë në 6 muaj të matësve të instaluar dhe në rastet kur verifikojnë gabime të mëdha gjatë matjeve, duhet të bëjnë kolaudimin ose zëvendësimin e tyre.

9. Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit janë humbje reale, që përfshijnë të gjitha rrjedhjet reale që ndodhin në linjat e transmetimit. Këto humbje mund të llogariten si diferencë e prurjes në fillim dhe në fund të linjës së dërgimit minus humbjet për shkak të lidhjeve të paligjshme, të cilat janë humbje të dukshme dhe mund të investigohen në vend. Këto matje duhet të regjistrohen çdo muaj me anë të një procesverbali zyrtar dhe duhet të dorëzohen në zyrat qendrore të operatorit, dega e shitjes. Dega e shitjes duhet të bëjë regjistrimin mujor të tyre.

10. Humbjet e ujit nga rrjedhjet në burim dhe/ose stacionet e pompave janë humbje reale që përfshijnë sasinë e ujit që humbet për shkak të rrjedhjeve të valvolave të komandimit, pjesëve të veçanta të sistemit të pompave (gominave, defekteve etj.) ose derdhjeve në zonën e grumbullimit të ujit të burimit (pusetave grumbulluese, kaptazheve etj.). Matjet e këtyre humbjeve duhet të bëhen në bazë të investigimit në vend të specialistëve të operatorit dhe të regjistrohen çdo muaj me anë të një procesverbali zyrtar, i cili duhet të dorëzohet në zyrat qendrore të operatorit, dega e shitjes, e cila bën regjistrimin mujor të tyre. Informacioni për këto rrjedhje duhet të dërgohet te dega e operim-mirëmbajtjes për të marrë masa të shpejta për zvogëlimin e tyre.

11. Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rezervuarët e ujit janë humbje reale që shkaktohen në rezervuarët e ujit, si rrjedhojë e defekteve të tepërplotësve, rrjedhjeve të vogla në muret e rezervuarëve (nëse ka), mosoperimit në kohën e duhur të valvolave të kontrollit të rezervuarëve etj. Në rast të defekteve të tepërplotësve apo rrjedhjeve në muret e rezervuarëve duhet të bëhen investigime dhe matje në terren, të paktën një herë në muaj. Këto humbje nuk duhet të jenë më shumë se 1 % e sasisë ditore të ujit që rezervohet në rezervuar.

Në rastet kur kalohet kjo shifër, duhet të merren masat për riparimin e këtyre defekteve. Matjet e këtyre humbjeve duhet të bëhen në bazë të investigimit në vend të specialistëve të operatorit dhe të regjistrohen çdo muaj me anë të një procesverbali zyrtar, i cili duhet të dorëzohet në zyrat qendrore të operatorit, dega e shitjes, e cila bën regjistrimin mujor të tyre. Informacioni për këto rrjedhje duhet të dërgohet te dega e operim-mirëmbajtjes për të marrë masa të shpejta për zvogëlimin e tyre.

Në rastet kur humbjet ndodhin për shkak të mosoperimit në kohën e duhur të valvolave duhet të bëhet regjistrimi i kohës së rrjedhjeve për shkak të këtij mosoperimi dhe, më pas, të bëhet llogaritja e sasisë së humbur të ujit në bazë të diametrit të tubit hyrës në rezervuar. Shpejtësia e ujit në këto raste mund të merret jo më shumë se $1 \text{ m}/\text{sek}$.




12. Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e rrjetit shpërndarës janë humbje reale që shkaktohen në linjat e rrjetit shpërndarës për shkak të rrjedhjeve të ujit, si pasojë e defekteve apo amortizimit të linjave të rrjetit shpërndarës nga rezervuarët e ujit deri te pika e lidhjes për konsumatorin.

Për sa më sipër, këto humbje mund të llogariten si diferencë e prurjes në fillim dhe në fund të linjës shpërndarëse minus humbjet për shkak të lidhjeve të paligjshme, të cilat janë humbje të dukshme dhe mund të investigohen në vend. Këto matje duhet të regjistrohen çdo muaj me anë të një procesverbali zyrtar dhe duhet të dorëzohen në zyrat qendrore të operatorit, dega e shitjes, e cila duhet të bëjë regjistrimin mujor të tyre.

13. Humbjet e ujit nga rrjedhjet gjatë riparimeve në linjat e sistemit të furnizimit me ujë janë humbje reale për shkak të rrjedhjeve gjatë riparimeve që kryhen në linjat e tubacioneve të sistemit të furnizimit me ujë. Kjo sasi varet nga gjatësia e kohës së riparimit, presioni i ujit, si dhe diametri i tubacionit ku kryhet ky riparim. Nga eksperiencia rezulton se gjatë riparimeve që kryhen në linjat e sistemit të furnizimit me ujë:

- Për tuba me presion < 10 bar dhe diametër $d < 200$ mm, këto humbje shkojnë deri në $40 \text{ m}^3/\text{orë}$;
- Për tuba me presion < 10 bar dhe diametër $200 < d < 400$ mm, këto humbje shkojnë deri në $400 \text{ m}^3/\text{orë}$;
- Për tuba me presion < 10 bar dhe diametër $400 < d < 600$ mm, këto humbje shkojnë deri në $2000 \text{ m}^3/\text{orë}$.

D. Skema principale e sistemit



(*) - mund të lokalizohet kudo afer pikes se hyrjes dhe te trajtimit

(**) - mund të lokalizohet kudo poshte trajtimit

E. Modeli tip i tabelës së “Bilancit të ujit” që duhet të plotësohet nga operatori

Tabela 2:

Emri i shoqërisë ujësjellës-kanalizime _____

Nr. i popullsisë në zonën e shërbimit:

Nr. i popullsisë së shërbyer me furnizim me ujë:

Muaji _____ Viti: _____

Nr.	Zëri		Njësia	Sasia	Vërejtje/komente
					(i matur/ i vlerësuar)
1	Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	i matur	m ³		
		i vlerësuar			
2	Konsumi i ujit të faturuar i matur		m ³		
3	Konsum i ujit të faturuar të matur që shitet te të tretët		m ³		
4	Konsum i ujit të faturuar i pamatur		m ³		
5	Konsumi i ujit i pafaturuar për sistemet zjarrfikës, inst. të veçanta, pastrim deposh	i matur	m ³		
		i pamatur	m ³		
	a) sistemi zjarrfikës (nëse është vendosur të dhurohet)		m ³		
	b) institucionet fetare dhe bamirësie (kisha, xhami, jetimore, azil etj.) (nëse është vendosur nga këshilli mbikëqyrës të dhurohet)		m ³		
	c) pastrimi i depove dhe i rrugëve		m ³		
6	Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit		m ³		
7	Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës		m ³		
8	Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit	në prodhim	m ³		
		te konsumatori	m ³		
9	Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit (nga stacioni i pompave deri në depo)		m ³		
10	Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim (rrjedhje të valvolave, pompave etj.) (nëse ka)		m ³		
11	Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në depot e ujit		m ³		
12	Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes		m ³		
13	Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të ujësjellësit		m ³		

Shënim. Të dhënat e zërit 1 (vëllimi vjetor i ujit të prodhuar) duhet të jenë të barabarta me shumën e zërave 2+3+4+5+6+7+8+9+10+11+12+13.

Humbjet për shkak të riparimeve do të llogariten në bazë të numrit të riparimeve.

Në konsumatorët jofamiljarë do të përfshihen konsumatorët privatë dhe institucionet.



VENDIM
Nr. 47, datë 30.12.2013

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA UK TEPELENË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, si dhe vendimit të KKRR-së nr. 35, datë 14.10.2013 “Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2014”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave fikse për sh.a. UK Tepelenë:

Konsumator familjar	90 lekë/muaj/klient
Institucione buxhetore	400 lekë/muaj/klient
Ente private	250 lekë/muaj/klient
2. Pagesa rregullatore vjetore për sh.a. UK Tepelenë do të jetë 0.8% e të ardhurave të llogaritura.
3. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2014 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr. 48, datë 30.12.2013

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR BASHKINË PUKË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, si dhe vendimit të KKRR-së nr. 35, datë 14.10.2013 “Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2014”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të bashkisë Pukë:
 - a) Tarifë volumetrike për shërbimet:

	Furnizimi me ujë	Largimi i ujërave të ndotura
Konsumator familjar	35 lekë/m ³	8 lekë/m ³
Institucione buxhetore	130 lekë/m ³	16 lekë/m ³
Ente private	140 lekë/m ³	16 lekë/m ³
 - b) Tarifë fikse: 100 lekë/muaj/klient.
2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2014:

- uji pa të ardhura (humbjet)	66 %
- niveli i matjes	70 %
- kohëzgjatja e furnizimit	10 orë/ditë
- efikasiteti i stafit	10 p/000/lidhje
- mbulimi me ujë	60 %
- mbulimi me kanalizime	54 %
- norma e arkëtimit	85 %
- cilësia e ujit (klor + koliform)	sipas standardeve.

3. Paga rregullatore vjetore për bashkinë Pukë do të jetë 0.8% e të ardhurave të llogaritura.
4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2014 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr. 49, datë 30.12.2013

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA UK SARANDË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, si dhe vendimit të KKRR-së nr. 35, datë 14.10.2013 “Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2014”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të sh.a. UK Sarandë:
 - a) Tarifë volumetrike për shërbimet:

	Furnizimi me ujë	Largimi i ujërave të ndotura
Konsumator familjar	50 lekë/m ³	18 lekë/m ³
Institucione buxhetore	135 lekë/m ³	28 lekë/m ³
Ente private	135 lekë/m ³	28 lekë/m ³
 - b) Tarifë fikse: 120 lekë/muaj/klient.
 - c) Tarifë shitje uji me shumicë: 30 lekë/m³.
2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2014:
 - uji pa të ardhura (humbjet) 70 %
 - niveli i matjes 70 %
 - kohëzgjatja e furnizimit 6 orë/ditë
 - efienca e energjisë 0.72 kwh/m³
 - efikasiteti i stafit 3.6 p/000/lidhje
 - mbulimi me ujë 100 %
 - mbulimi me kanalizime 94 %
 - norma e arkëtimit 75 %
 - cilësia e ujit (klor + koliform) sipas standardeve.
3. Paga rregullatore vjetore për sh.a. UK Sarandë do të jetë 0.8% e të ardhurave të llogaritura.
4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2014 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.
5. Vendimi i KKRR-së nr. 7, datë 9.4.2012 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik”, shfuqizohet.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr. 50, datë 30.12.2013

**PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË LICENCËS DHE DISA NDRYSHIME NË
RREGULLOREN E LICENCIMIT**

Në zbatim të nenit 14, germa “e” dhe “i” të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, Komisioni Kombëtar Rregullator



VENDOSI:

1. Të miratojë formatin e licencës sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë e pandarë e tij.
 2. Formatin e licencës përbëhet nga certifikata e licencës dhe kushtet e licencës, të cilat nënshkruhen nga ERRU-ja.
 3. Në rregulloren e licencimit bëhen këto ndryshime:
 - a) Në nenin 5, pika 2, fjalia e parë “Rinovimi i licencës brenda këtij afati për shkak të ndryshimit të drejtuesit teknik apo ligjor do të ketë kohëzgjatjen e licencës”, shfuqizohet;
 - b) Në nenin 9, pika “d”, togfjalëshi “deri në vendimmarrjen e KKRRU-së”, shfuqizohet;
 - c) Në nenin 11, paragrafi i katërt, togfjalëshi “ndryshimi i drejtuesit ligjor apo teknik”, shfuqizohet;
 - d) Neni 11/1 shfuqizohet;
 - e) Në nenin 12, pas paragrafit të fundit, shtohet fjalia “Kushtet e detajuara të licencës dhe certifikata e licencës gjenden në aneksin 6 të rregullores”.
 4. Licencat e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi do të ndryshojnë sipas modelit të ri brenda datës 30 qershor 2014.
 5. Vendimi nr. 25, datë 2.12.2009 “Për miratimin e formatit të licencës”, shfuqizohet.
 6. Ngarkohen Sektori Juridik dhe i Marrëdhënieve me Publikun dhe Sektori Teknik dhe IT për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi në datën 30.12.2013.

KRYETARI
Avni Dervishi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT
ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA



LICENCË
NR. ____

PËR GRUMBULLIMIN, SHPËRNDARJEN, PËRPUNIMIN E UJIT PËR KONSUM PUBLIK DHE
LARGIMIN E PËRPUNIMIT E UJËRAVE TË NDOTURA

Vendimi nr. ____, datë ____-____-____ i KKRR-së

Operatori: shoqëria anonime Ujësjetllës-Kanalizime

Adresa:

Afati i licencës: Nga deri më

Zona e shërbimit: Bashkia: Komuna

Kategoritë e shërbimit:

1. Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
2. Kategoria B: Për përpunimin e ujit për konsum publik;
3. Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura;
4. Kategoria D: Për përpunimin e ujërave të ndotura.

Kushtet e licencës:

Kjo licencë lëshohet në përputhje me ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996, i ndryshuar, si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kushtet e licencës sipas tekstit bashkëlidhur janë pjesë e pandarë e kësaj licence. Operatori në ushtrimin e aktivitetit të tij vepron në pajtim me kushtet e përcaktuara të licencës.

PËR KOMISIONIN KOMBËTAR RREGULLATOR
AVNI DERVISHI
KRYETARI



**KUSHTET E LICENCËS
PËR GRUMBULLIMIN, SHPËRNDARJEN, PËRPUNIMIN E UJIT PËR KONSUM PUBLIK
DHE LARGIMIN E PËRPUNIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA**

Nr. i licencës _____, vendimi i KKRR-së _____, datë ____ . ____ . ____

I jepet: _____
(emri i plotë i të licencuarit)

Enti Rregullator i Ujit harton këto kushte licence, të detyrueshme për t'u zbatuar nga operatori në ushtrimin e veprimtarisë së tij, gjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së licencës.

Këto kushte hartohen në zbatim të legjislacionit në fuqi në sektorin ujësjellës-kanalizime. Për sa nuk parashikohen në këto kushte licence, zbatohen aktet ligjore e nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Përkufizime

1. Fjalët dhe frazat e përdorura në kushtet e licencës kanë këtë kuptim:

- "ERRU" është Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, që vepron sipas ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura";

- "KKRR" është Komisioni Kombëtar Rregullator që udhëheq Entin Rregullator të Ujit, që funksionon në bazë të ligjit nr. 8102 (i ndryshuar);

- "Licencë" do të thotë leja profesionale që i jepet një personi fizik apo juridik në përputhje me ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996, të ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 për ushtrimin e aktivitetit në sektorin e furnizimit me ujë, largimit të ujërave të ndotura dhe përpunimit të tyre;

- "I licencuar" do të thotë një person juridik apo fizik që mban një licencë të dhënë nga ERRU-ja për të operuar në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura sipas kategorive të dhëna nga KKRR-ja;

- "Certifikatë e licencës" do të thotë formati i lejes profesionale, miratuar nga KKRR-ja;

- "Dokumentet e aplikimit" do të thotë dokumentet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 dhe rregulloren e licencimit miratuar nga Komisioni;

- "Pagesa e licencimit" janë pagesa, të vendosura sipas ligjit, të detyrueshme për të licencuarin, që operojnë në sistemet e furnizimit me ujë dhe sistemet e kanalizimeve, të cilat duhet të bëhen përpara marrjes së licencës përkatëse;

- "Drejtues ligjor" do të thotë personi fizik i emëruar apo i caktuar me një marrëveshje juridike, nga pronari për të administruar në përputhje me ligjin në sistemet përkatëse të furnizimit me ujë, largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura;

- "Drejtues teknik" do të thotë një individ me aftësitë e duhura për drejtimin teknik të operatorit të licencuar nga KKRR-ja, i cili përmbush të gjitha kriteret e kërkuara nga ligji dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009;

- "Konsumatorë" janë të gjitha kategoritë e përfituesve familjarë, publikë dhe privatë (të tanishëm dhe në të ardhmen), të cilët përdorin shërbimet e furnizimit me ujë dhe/ose kanalizimeve;

- "Konsumatorë familjarë" nënkupton ata konsumatorë që i shfrytëzojnë shërbimet UK në objektin e banimit;

- "Konsumatorë privatë" nënkupton ata konsumatorë që përcaktohen nga legjislacioni në fuqi si persona fizikë e juridikë me natyrë tregtare;

- "Konsumatorë publikë" nënkupton subjektet ligjore, të tilla si: institucione qendrore, vendore, ente publike, si dhe çdo organ tjetër të administratës shtetërore që nuk ka natyrë tregtare;

- "Sistemi i furnizimit me ujë" përbëhet nga tërësia e elementeve, si: vepra e marrjes, sistemi i pompave, njësitë e dezinfektimit, rezervuarët, linjat e transmetimit dhe rrjeti shpërndarës;

- “Sistemi i kanalizimeve” është sistemi që përbëhet nga tërësia e elementeve, si: linjat e shkarkimit/grumbullimit të ujërave të ndotura, linjat e largimit dhe/ose stacionet e pompimit të ujërave të ndotura, veprat e shkarkimit të tyre në trupat ujorë pritës, si dhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura (nëse sistemi është i pajisur me to);

- “Shërbimet UK” është tërësia e shërbimeve të kryera nga operatorët te konsumatorët përmes sistemeve të furnizimit me ujë, si dhe sistemeve të grumbullimit, largimit dhe/ose trajtimit të ujërave të ndotura;

- “Zona e shërbimit” është zona, ku operatori i licencuar është përgjegjës të ofrojë shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime;

- “Tarifë” është çmimi për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura i miratuar nga KKRR-ja.

2. Fjalët dhe frazat e tjera, të përdorura në këto kushte licence, kanë të njëjtin kuptim me ato të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore të sektorit ujësjellës-kanalizime.

Të përgjithshme

3. Enti Rregullator i Ujit është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur sipas ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin ligjor të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, që lëshon dhe deklaron hyrjen në fuqi të kësaj licence.

4. I licencuari është i detyruar të zbatojë legjislacionin në fuqi, rregullat, procedurat, metodikat, standardet e miratuara nga ERRU-ja.

5. Kohëzgjatja e kësaj licence është 4 (katër) vjet. Kohëzgjatja përcaktohet nga performanca dhe qëndrueshmëria e shoqërisë që licencohet dhe do të pasqyrohet në certifikatën e licencës.

6. Kjo licencë nuk mund t’i transferohet të tretëve pa miratimin paraprak me shkrim të KKRR-së. Kur miraton një transferim, KKRR-ja mund ta modifikojë periudhën e licencës ose kushtet e tjera të licencës.

7. KKRR-ja me iniciativën e vet dhe/ose me kërkesë të të licencuarit mund të ndryshojë licencën dhe kushtet e licencës, në përputhje me nenin 17 dhe 18 të ligjit nr. 8102. I licencuari mund të kërkojë ndryshim të kësaj licence nëpërmjet një kërkesë të detajuar me shkrim, shoqëruar me arsyet përkatëse. Një kërkesë e tillë mund të miratohet vetëm nëse ky ndryshim nuk çon në ulje të cilësisë së shërbimit, ose në rritje të çmimeve dhe tarifave për klientët e të licencuarit.

8. KKRR-ja ndryshon licencën në rastet e mëposhtme:

- kur ka ndryshime në elementet e licencës;
- kur rrezikohet jeta e qytetarëve ose dëmtimi i shëndetit të tyre, si dhe dëmtimi i mjedisit ose dëmtimi i pasurisë së palëve të treta, kur rreziku nuk kërkon heqjen e licencës;
- kur në licencë është bërë një gabim i qartë faktik;
- kur ka ndryshime në kuadrin ligjor të sektorit të shërbimeve ujësjellës-kanalizime, pa përjashtuar ndryshimet në kuadrin ligjor kombëtar, ndryshime të rrethanave të lëshimit të licencës, vendime të formës së prerë të gjykatës, ose ngjarjeve që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në administrimin e sistemeve të furnizimit me ujë, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura etj.

9. I licencuari duhet t’i parashtrojë ERRU-së një kërkesë me shkrim për rinovimin e licencës jo më pak se 3 muaj para përfundimit të afatit të licencës së dhënë. Afati i licencës do të zgjatet kur KKRR-ja, bazuar në ligjin nr. 8102, rregulloren e licencimit dhe në prova të besueshme, konkludon se i licencuari i ka përmbushur kushtet e licencës dhe i është përmbajtur kërkesave të gjithë legjislacionit në fuqi gjatë afatit të licencës.

10. I licencuari është i detyruar të paguajë, për aplikimin për licencën dhe rinovimin e saj, tarifën e përcaktuar nga ERRU-ja.

11. Kjo licencë mund të transferohet vetëm me vendim me shkrim të KKRR-së dhe sipas afateve dhe kushteve të vendosura nga ai. KKRR-ja transferon licencën vetëm nëse gjykon se personi, të cilit i transferohet licenca ka aftësinë teknike dhe financiare për të plotësuar afatet dhe kushtet e kësaj licence.

12. Çdo transferim i kësaj licence pa miratimin e KKRR-së është i pavlefshëm dhe përbën një shkelje të kësaj licence.



13. I licencuari është i detyruar të paguajë për aplikimin për licencë dhe rinovimin e saj, tarifën e përcaktuar nga KKRR-ja.

14. I licencuari do të paguajë rregullisht dhe në mënyrë të vazhdueshme pagesat e rregullimit gjatë kohëzgjatjes së kësaj licence, siç përcaktohet nga ligji nr. 8102.

15. I licencuari duhet të njoftojë ERRU-në jo më vonë se 30 ditë, kur ndërmerr ndonjë veprimtari tjetër përveç veprimtarisë për të cilën është licencuar.

16. KKRR-ja mund ta ndalojë të licencuarin të kryejë ndonjë veprimtari tjetër përveç asaj të licencuar, ose mund të vendosë kushte për kryerjen e kësaj veprimtarie, me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve.

17. I licencuari duhet t'i paraqesë ERRU-së çdo informacion që është i domosdoshëm për njohjen e situatës nga ERRU-ja për të kryer përgjegjësitë rregullatore sipas ligjit. Informacioni duhet të paraqitet sipas formës dhe brenda kohës së vendosur nga ERRU-ja.

18. ERRU-ja ka të drejtë të kontrollojë zbatimin e kushteve të licencës, dokumentacionin e të licencuarit dhe çdo të dhënë tjetër për të verifikuar përputhjen e kryerjes së aktivitetit me kushtet e licencës, rregullat dhe standardet në fuqi.

19. Përfaqësuesit e autorizuar të ERRU-së kanë të drejtë të inspektojnë dokumentacionin e veprimtarisë, ambientet dhe pajisjet e të licencuarit.

Veprimtaria e të licencuarit

20. I licencuari autorizohet nga kjo licencë për kryerjen e veprimtarisë sipas kategorive të përcaktuara në licencë brenda zonës së shërbimit. Kjo e drejtë i jepet ekskluzivisht të licencuarit.

21. Gjatë afatit të licencës, i licencuari ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimtaritë që kërkohen për përmbushjen e licencës. I licencuari mund të përdorë të gjitha mjetet që i njeh ligji, për të siguruar financimin e veprimtarive të licencuara.

22. I licencuari në marrëdhëniet me konsumatorët zbaton kushtet e kontratës model të aprovuar nga KKRR-ja, përfshirë furnizimin në sasi dhe cilësinë e duhur me ujë për konsum publik dhe mbledhjen dhe largimin e ujërave të ndotura për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.

23. I licencuari nuk ka të drejtë të vendosë tarifa për konsumatorët, përveç atyre të miratuara nga KKRR-ja dhe ato që lejojnë aktet normative në sektor.

24. I licencuari gjatë ushtrimit të veprimtarisë nuk mund të bashkëpunojë me të licencuar të tjerë në dëm të konsumatorëve.

25. I licencuari duhet të kryejë veprimtarinë e tij në përputhje me parimet e eficiencës ekonomike, duke pasur si objektiv arritjen e kostove më të ulëta, dhe duke zbatuar njëkohësisht standardet dhe objektivat e përcaktuar nga KKRR-ja.

26. I licencuari nuk do të hyjë në asnjë marrëveshje që mund të rezultojë në shkelje të kushteve të licencës ose të ndonjë dispozite tjetër ligjore e nënligjore në fuqi.

27. I licencuari nuk do të angazhohet në veprimtari të tjera që pengojnë ose mund të pengojnë kryerjen si duhet të veprimtarisë së licencuar.

28. I licencuari nuk do të pengojë, parandalojë ose të përpiqet të parandalojë të licencuar të tjerë apo konkurrentë potencialë që të angazhohen ligjërisht në tregun e sektorit ujësjellës-kanalizime.

29. I licencuari duhet të dorëzojë pranë ERRU-së deri më 31 dhjetor të çdo viti, një raport vjetor lidhur me veprimtarinë e tij gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, i cili përmban:

- të dhënat për treguesit e performancës të miratuar nga KKRR-ja;
- regjistrin e konsumatorit sipas modelit të miratuar nga KKRR-ja;
- "Bilancin e ujit";
- kostot;
- të dhëna mbi zbatimin e kontratës model;
- numrin e ankesave dhe problematikat kryesore;
- çdo problem që shfaqet gjatë vitit.

30. I licencuari do të dorëzojë në KKRR deri në fund të muajit prill të çdo viti, raportin e ekspertit kontabël dhe pasqyrat kontabël të sipërmarrjes së tij dhe të çdo njësie biznesi të veçantë në atë formë dhe me atë nivel detajesh, siç dorëzohet në organet tatimore.

31. I licencuari do ta njoftojë ERRU-në brenda 30 ditëve për çdo ndryshim të:

- adresës;
- statutit të të licencuarit;
- certifikatës së regjistrimit;
- drejtuesve ligjorë dhe teknikë;
- aksioneve deri në 5 %;
- ndryshim të rrethanave që ndikojnë në kushtet e licencës;
- zonës së shërbimit;
- skemave të sistemeve të furnizimit me ujë, si dhe largimit apo trajtimit të ujërave të ndotura.

32. I licencuari punëson një ose më shumë drejtues teknikë për ushtrimin e aktivitetit të tij. Marrëdhëniet e punës vërtetohen me kontratë noteriale, një kopje e së cilës i vihet në dispozicion ERRU-së. I licencuari nuk mund të ushtrojë veprimtarinë e tij në mungesë të drejtuesit/ve teknikë.

33. Drejtuesi teknik është punonjës me kohë të plotë. Ai nuk mund të jetë i punësuar në një ose më shumë operatorë të tjerë shërbimi ujësjellës-kanalizime.

34. Kur drejtuesi ligjor dhe/ose drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 3 muaj, invaliditet, ndarje nga jeta), i licencuari njofton ERRU-në dhe dërgon dokumentacionin përkatës për drejtuesin e ri ligjor apo teknik.

35. Licenca e shërbimit rinovohet sa herë që ka ndryshime në zonën e juridiksionit, kategorive të shërbimit dhe në rastet e riorganizimit të shoqërisë, pavarësisht se afati i vlefshmërisë nuk ka përfunduar. I licencuari paraqet aplikimin për rinovim licence për shkaqet e mësipërme brenda 30 ditëve nga lindja e tyre.

36. I licencuari, jo më vonë se 3 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës, paraqet pranë ERRU-së kërkesën për rinovimin e licencës, shoqëruar me dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesën me shkrim për licencim sipas formatit të aprovuar nga ERRU-ja, duke shprehur qartë kategoritë e shërbimit që kërkon të kryejë, si dhe zonën e juridiksionit ku do të operojë;
- Formularin e aplikimit, aprovuar nga ERRU-ja, dhe të plotësuar sipas kërkesave të ligjit, VKM-së dhe rregullores së licencimit të ERRU-së;
- Dokumentacionin e kërkuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009;
- Në kërkesën për rinovim të licencës, i licencuari paraqet ndryshimet në kushtet e saj, nëse ka të tilla, ose konfirmon kushtet aktuale të licencës.

37. I licencuari është i detyruar të kryejë veprimtaritë e specifikuar në licencë. Nëse gjatë kryerjes së veprimtarisë së licencuar, shfaqen rrethana për të cilat i licencuari në mënyrë të arsyeshme nuk është në gjendje të kryejë veprimtaritë e specifikuar në licencë, i licencuari do të njoftojë menjëherë KKRR-në dhe do të ndjekë udhëzimet e tij.

38. I licencuari nuk ka të drejtë të bëjë marrëveshje me një person të tretë, për shitjen e ujit të pijshëm me shumicë për qëllime tregtare, pa miratimin e KKRR-së.

39. E gjithë korrespondenca zyrtare do të jetë në formë shkresore.

40. Veprimtaria e të licencuarit për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve nën administrim duhet të bëhet në përputhje me rregullat e mbrojtjes dhe sigurisë në punë.

41. Mbrojtja e objekteve të burimeve ujore dhe sistemeve nën administrim duhet të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kryerja e shërbimit

42. I licencuari do të sigurojë akses në sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve dhe do të trajtojë konsumatorët e tij në bazë të drejtë, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.

43. I licencuari duhet të zbatojë tarifën e miratuar nga KKRR-ja për kategoritë e shërbimit, sipas kategorive të konsumatorëve.

44. I licencuari para se të bëjë propozimin për ndryshimin e tarifave duhet të organizojë seancën dëgjimore me publikun, sipas përcaktimeve të metodologjisë së tarifave.



45. Operatori nuk ka të drejtë të aplikojë për tarifë në shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura në rast se nuk është i licencuar apo në rast se i ka mbaruar afati i licencës.

46. I licencuari është i detyruar për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë së ujit sipas standardeve të cilësisë së ujit të miratuara me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

47. I licencuari duhet të sigurojë ndjekjen dhe zgjidhjen në kohë të ankesave të konsumatorëve. ERRU-ja në bazë të një anese ose edhe me iniciativën e vet mund të nisë një hetim për respektimin nga i licencuari të akteve normative, kushteve të licencës dhe rregullave të tjera të KKRR-së.

48. Rekomandimet e ERRU-së mbi ankesat e konsumatorëve janë të detyrueshme për t'u zbatuar.

49. I licencuari do të përgatisë dhe do të përditësojë regjistrin e aseteve të veta.

Pezullimi dhe heqja e licencës

50. KKRR-ja mund të pezullojë licencën e të licencuarit, nëse:

- ai nuk zbaton legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore të nxjerra nga KKRR-ja;
- ai shkel kushtet e licencës;
- nuk paraqitet brenda afatit të caktuar nga KKRR-ja për ndryshimin e kushteve të licencës.

51. KKRR-ja mund të heqë licencën sipas ligjit nr. 8102 dhe procedurave të përcaktuara në rregullat e ERRU-së, kur:

- i licencuari shkel në mënyrë të përsëritur kushtet e licencës;
- i licencuari shkel në mënyrë të përsëritur legjislacionin në fuqi;
- i licencuari kërkon heqjen e licencës;
- i licencuari e ka marrë licencën me mashtrim;
- i licencuari deklarohet i falimentuar dhe nuk është i aftë të kryejë detyrimet sipas kushteve të kësaj licence;

- shkrihet personi që mban licencën.

Pezullimi dhe heqja e licencës nuk përjashton mundësinë për vendosjen e sanksioneve monetare sipas akteve ligjore në fuqi.

Moszbatimi i kushteve të licencës dënohet me gjobë në shumën 50 000 lekë.

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 977, datë 17.12.2013, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Thoma Prifti, i biri i Sotirit dhe i Vasilies, i datëlindjes 7.10.1964, lindur në Divjakë, Lushnjë, si dhe caktimin si datë vdekjeje, datën 1.4.1992.

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 11 010, datë 24.12.2013, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Sefer Rabeta, i biri i Hajdarit dhe i Zojës, i datëlindjes 5.3.1892, i lindur në Varosh Tiranë, duke caktuar si datë të vdekjes së tij, datën 1.1.1971 dhe si vend të vdekjes së tij, rrethin Tiranë.

NDREQJE GABIMI

Në Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 12 dhjetor 2013,

1. Në vendimin e ERE-s nr. 137, datë 15.11.2013 “Për shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k.”, në faqen 7983, në pikën 1:

Ishte:

... vendimin nr. 93, datë 06.09.2010...

Bëhet:

... vendimin nr. 93, datë 26.09.2011...

2. Në vendimin e ERE-s nr. 138, datë 15.11.2013 “Për shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k.”, në faqen 7984, në pikën 1:

Ishte:

... vendimin nr. 92, datë 06.09.2011...

Bëhet:

... vendimin nr. 92, datë 26.09.2011...

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 24 lekë